



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË KORÇË

ANALIZA VJETORE E VITIT 2015



Pasuria e një shteti është drejtësia! - Konfuci (551 – 479 p.e.s.) - mendimtar

The wealth of a country is justice! - Confucius (551 – 479 b.c.) - thinker

Pak fjalë...

Në fillim dua të falënderoj të gjithë prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore, stafin administrativ mbështetës, që në punën tonë të përditshmenga 01 janar 2015deri me 31dhjetor 2015 kanë përfaqësuar denjësisht shtetin në përmbushje të detyrave të tyre funksionale.

Gjithashtu një falenderim i veçantë për subjektet e tjera proceduriale, gjykatën, palën mbrojtëse, IEVP-në, institucionin e doganave, tatimeve etj që na kanë mundësuar që ndjekja penale të jetë brenda afateve ligjore dhe në përputhje me ligjin.

Shteti duke qënë një nocion sa abstrakt aq edhe konkret, ekziston dhe përfaqësohet pavarësisht emrit konkret të titullarit të saj, në këtë kuptim Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë gjatë vitit kalendarik 2015 ka ushtruar ndjekjen penale, si dhe ka përfaqësuar akuzën në gjyq në emër të shtetit, me integritet profesional dhe në marrëdhënie korrekte me të gjitha subjektet proceduriale penale pjesëmarrëse në një proces penal.

Në këtë analizë të vitit që kaloi konstatohet se, në ushtrimin e kompetencave të tyre prokurorët u janë nënshtruar Kushtetutës dhe ligjeve. Prokurorët i kanë ushtruar kompetencat e tyre duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes të së drejtave, të interesave dhe të lirive të ligjshme të njeriut. Prokuroria si një trup i vetëm ka zhvilluar hetime me diskrecionin që e kërkon ligji, duke qëndruar gjithmonë larg përfshirjeve mediatike.

Të nderuar kolegë për shkak të natyrës së organit tonë, jemi të detyruar të qëndrojmë të heshtur edhe kur pa të drejtë na sulmojnë institucionalisht apo personalisht. Për këtë arsye kërkoj nga Ju që edhe në këtë vit në vazhdim të rezervoni diskrecionin që ju karakterizon. Kaliteni durimin tuaj mbi standartin e një njeriu të zakonshëm, qëndroni të barazlanguar nga palët dhe interesat e tyre në proces, dhe në çdo rast të respektoni ligjet dhe kushtetutën. Vetëm në këtë mënyrë shteti dhe prokuroria shqiptare, nëpërmjet nesh si përfaqësues të denjë të saj, do të ketë imazhin dhe përfaqësinë dinjitoze që kërkohet nga sovran.

Lëreni punën tonë të flas vetë!

HYRJE

1. ANALIZË E PËRGJITHSHME

Kriminaliteti në qarkun e Korçës, gjatë vitit 2015, ka përfshirë një tërësi ngjarjesh, si të ngjashme ashtu edhe të ndryshme ndërmjet njera – tjetrës që kanë cënuar të mirat dhe të drejtat e mbrojtura me ligj.

Është vërejtur se kriminaliteti ekonomik ka vazhduar të mbetet shqetësues ndër vite, ndikuar natyrisht edhe nga faktorët ekonomikë, si niveli i papunësisë, reçensioni ekonomik etj.

Objektivi i kësaj analize është t’ju bëjë me dije një njohje shumëdimensionale për vijueshmërinë e kriminalitetit në qarkun e Korçës, për juridiskionin brenda të cilit ushtrojmë detyrën, të autorëve të veprave penale dhe të viktimave, interesat legjitime të të cilëve përfaqësojmë.

Pasqyrimi në këtë analizë i punës së kësaj prokurorie, merr një rëndësi të veçantë jo vetëm për atëçka kanë bërë punonjësit e atashuar pranë saj, por edhe për rolin që ka luajtur policia gjyqësore dhe gjykata.

Veprat penale kryhen, apo tentohen të kryhen dhe është e nevojshme që ato të diktohen nga policia apo insitucionet e tjera dhe në fund edhe të procedohet, bazuar mbi prova të plota përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, vënien para përgjegjësisë të autorëve të tyre. Roli i policisëgjyqësore në disa raste është vendimtar në kuptimin që zbulimi dhe më pas rregjistrimi i veprave penale kërkon një veprimtari investigimi të zhvilluar nga forcat e policisë. Në raste të tjera rregjistrimi vjen si pasojë e ankesës së shtetasve apo subjekteve të tjerë.

Megjithatë ndodh që edhe shumë vepra penale të tjera mbeten të fshehura, të padenoncuar. Kjo duhet të jetë edhe sfida e punës tonë të përditshme për të ardhmen profesionale. Të rrisim kontrollin ndaj policisë gjyqësore në një mbikqyrje më të pranishme gjatë hetimeve paraprahe, në mënyrë që të minimizojmë sa më shumë që të jetë e mundur *pafajsitë* në gjykatë.

Profesionalizmi, transparenca dhe efienca janë ato që duam të tregojmë në këtëanalizë vjetore. Vetëm nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm të asaj çfarëështë bërë,është e mundur që të përmirësohemi, duke përcaktuar cdo vit synime të reja për tu arritur.

2. STRUKTURA ORGANIZATIVE

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, për ushtrimin e veprimtarisë së saj, ka patur për vitin 2015 një organikë prej 36 punonjësish definitivë (1 drejtues dhe 2 zv/drejtues, 11 prokurorë, 6 oficerë të policisë gjyqësore, 1 kancelar, 1 k/sekretare, 1 finaciare, 3 shoferë, 1 ftues, 1 portier, 1 punonjës I.T., 6 sekretare/operatore, 1 punonjëse pastrimi) si dhe 1 punonjëse pastrimi me kohë të pjesshme, me kontratë.

Seksionit të policisë gjyqësore pranë kësaj Prokurorie i shtohen 3 oficerë të policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Korçë, 1 oficer i policisë gjyqësore të D.P.Doganave dhe 1 oficer i policisë gjyqësore të D.R.Tatimore. Njëkohësisht kanë dhënë ndihmën dhe mbështetjen e tyre shërbimet e policisë gjyqësore pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Korçë, Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit të cilët kanë përballuar një peshë të konsiderueshme të hetimeve paraprahe.

Sipas organizimit të brendshëm, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë kanë funksionuar rregullisht dy seksione, Njësia e Përbashkët Hetimore Kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit, aktualisht me 3 prokurorë (1 zv/drejtues dhe 2 prokurorë), Seksioni i të Miturve me 2 prokurorë dhe Seksioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale, me 1 prokuror.

Gjithashtu policia gjyqësore që merr pjesë në hetim është edhe në organizma të tjerë si ajo e SHKBB, SHKB, Pyjore, etj.

Tabelë organike numerike e prokurorisë

Funksioni	Organika	Efektive	Meshkuj	Femra
Drejtues	1	1	1	0
Zv/Drejtues/e	2	2	1	1
Prokurore/ë	11	11	9	2
Gjithsej	14	14		

3. NGARKESA E PUNËS NË 3 DIMENSIONE(VOLUM, CILËSI DHE SASI)

Me marrjen dijeni të veprës penale, prokuroria rregjistron materialin hetimor dhe ia cakton atë një prokurori, sipas lëndës, gadishmërisë apo kompetencës lëndore të posacme.


I. Treguesit sasiorë të çështjeve penale të trajtuara gjatë vitit 2015.

Gjatë vitit 2015, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë janë rregjistruar gjithsej 2.173 kallëzime dhe referime për vepra të ndryshme penale. Prej tyre janë rregjistruar gjithsej 1.569 procedime penale dhe është vendosur mosfillimi për 604 kallëzime penale. Gjatë vitit 2015 janë mbartur nga viti 2014 gjithsej 326 procedime penale dhe së bashku me ato të rregjistruara i takon të jenë trajtuar gjithsej 1895 procedime penale. 314 procedime penale janë rifilluar dhe pushuar per parashkrim. Ndërkohë që nga viti 2015 rezulton të jenë mbartur 381 procedime penale dhe referime për në vitin 2016.

Krahasuar këta tregues me vitet 2013, 2014, 2015 sipas tabelës së mëposhtme rezulton:

Totali i çështjeve të trajtuara		Të rregjistruara	Të mbartuara viti parardhës	Seksioni i të Miturve	Çështje të Njesisë (N.J.P.H.)
Viti 2015	2.499	1.569proc. + 604 mf	326	45	187
Viti 2014	2.867	1.749 pr.+ 697 mf	421	50	108
Viti 2013	2.280	1.534 pr + 490 mf	256	58	71


Në mënyrë grafike treguesit e mësipërm, paraqiten si më poshtë:



Për vitin 2015, ka patur një volum më të madh pune krahasuar me vitin 2013 por më të vogël krahasuar me vitin 2014, si rezultat i numërit më të vogël të njoftimeve për vepra penale të ardhura në Prokurori. Proporcionalisht dhe numri i procedimeve penale të regjistruara, si dhe numëri i mosfillimeve ka qënë më i vogël se në vitin 2014. Tregues i punës së kryer për vitin 2015 është numri i çështjeve të cilave u është dhënë zgjidhje ligjore, i cili është thajse i njëjtë në përqindje me vitin 2014 dhe më i lartë se viti 2013.

Viti	Totali i çështjeve të trajtuara	Çështje të përfunduara gjatë vitit 2015	Çështje të mbartuara për vitin pasardhës 2016
2015	$1569^1 + 326^2 + 604^3 = 2499$	$1514 + 604 = 2118$	381
2014	$1749 + 421 + 697 = 2867$	$1816 + 697 = 2513$	354
2013	$1534 + 256 + 490 = 2280$	$1310 + 490 = 1800$	480

Në mënyrë grafike treguesit e mësipërm paraqiten:



II. Burimet e referimit të çështjeve penale të regjistruara gjatë vitit 2015.

Përsa i përket burimeve të referimit të çështjeve penale të regjistruara dhe të trajtuara gjatë vitit 2015, duhet thënë se ato janë në proporcion të drejtë me vitet e mëparshme. Vihet re një rritje e lehtë e kallzimeve penale të referuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Më konkretisht treguesit e burimeve të referimit të çështjeve penale të regjistruara gjatë vitit 2015 janë:

¹Procedime të regjistruara për vitin 2015

²Procedime të mbartura prej vitit 2014

³Mosfillime për vitin 2015


Burimi i referimit	2013	2014	2015
Të rregjistruara kryesisht	2	3	3
Kallëzime nga nëpunësit publikë/institucionet	27	33	18
Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit	2	2	3
Nga ILDKPI	-	6	5
Nga Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave (FIU)			
Nga Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH)			
Nga Personeli mjekësor			
Nga Drejtoria e Tatim Taksave + Dogana	12	2	7
Kallëzime nga shtetas	56	84	51
Nga policia e shtetit	1996	2222	2058
Nga policia pyjore		8	
Nga OSSHE			
Nga I.N.U.V.-I.N.U.K.			
Të tjera		1	

Në këndvështrim të figurave të veprave penale konkrete për të cilat janë rregjistruar procedimet penale,rezulton si më poshtë :

Numri i procedimeve	Neni për të cilin janë trajtuar
11	Për nenin 84
72	Për nenin 89
65	Për nenin 130/a
525	Për nenin 134
29	Për nenin 137
5	Për nenin 139
6	Për nenin 141/a
19	Për nenin 143
21	Për nenin 150
26	Për nenin 151
12	Për nenin 183
28	Për nenin 186
16	Për nenin 197
25	Për nenin 199/a
33	Për nenin 248
23	Për nenin 275
13	Për nenin 278
36	Për nenin 283
29	Për nenin 284
10	Për nenin 287
9	Për nenin 289
49	Për nenin 290
104	Për nenin 291

20	Për nenin 297
11	Për nenin 298
370	Për nene të tjera

Në mënyrë grafike kjo ndarje pasqyrohet si më poshtë:



Të para në këndvështrim të grupimeve të veprave penale rezulton se janë regjistruar gjatë vitit 2015, për vepra penale kundër personit 210 procedime penale me 131 të pandehur, prej të cilëve 39 me masë sigurimi “Arrest në burg”; për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike janë regjistruar 877 procedime me 212 të pandehur, prej të cilëve 55 të arrestuar, për krime kundër mjedisit 33 çështje me 1 të pandehur; për vepra penale kundër autoritetit të shtetit 407 çështje me 237 të pandehur prej të cilëve 50 me masë sigurimi “arrest në burg”; për vepra penale kundër drejtësisë 30 çështje me 14 të pandehur.


Sikurse shihet nga grafiku i mësipërm, vepra penale për të cilën janë regjistruar më shumë procedime penale, është “Vjedhja”, e parashikuar nga neni 134 i K.Pr.Penale, e cila lidhet kryesisht me faktorë socialë-ekonomikë.

III. Treguesit e mënyrës së përfundimit të çështjeve penale të trajtuara gjatë vitit 2015.


Gjatë vitit 2015, janë trajtuar një numër i konsiderueshëm procedimesh penale, gjithsej 1895. Prej tyre janë përfunduar gjithsej 1514 procedime, prej të cilave 40,6% janë dërguar për gjykim, 25 % janë pushuar, 33,2% janë pezulluar dhe 1,2% janë dërguar për kompetencë. Janë mbartur për vitin 2016 gjithsej 381 procedime penale. Më konkretisht treguesit e mënyrës së përfundimit të çështjeve penale të trajtuara gjatë vitit 2015 duke i krahasuar edhe me të dhënat e viteve 2013 e 2014 janë si më poshtë:

Totali i çështjeve		Mosfillim	Pushim	Pezullim	Transferim	Gjykim	Të mbartura per vitin pasardhës
Viti 2015	2499	604	379	502	18	615	381
Viti 2014	2867	697	426	595	19	776	354
Viti 2013	2280	490	367	466	19	456	480

Në mënyrë grafike treguesit e mësipërm paraqiten si më poshtë.



Shprehur në përqindje, mënyra e përfundimit të çështjeve në vitin 2015 paraqitet si më poshtë:



Ajo që konstatohet nga të dhënat e mësipërme është fakti se numri i çështjeve penale të dërguara për gjykim dhe të pushuara, të pezulluara, të transferuara janë më të ulëta se viti 2014, por më të larta se viti 2013. Gjithsesi konstatohet se raporti i çështjeve të pezulluara, pushuara apo të dërguara për gjykim, me numrin total të çështjeve të rregjistruara, është pothuajse i njëjtë në të tre vitet të cilat janë marrë në analizë. Gjithashtu pothuajse në përpjestim të drejtë është edhe raporti i rasteve të mosfillimit me numrin total të materialeve kallzuese, të rregjistruara gjatë këtyre 3 viteve.

Pjesën kryesore të procedimeve penale të pezulluara e zënë ato për veprën penale të vjedhjes, sidomos të vjedhjes së banesave. Ky fenomen është i përhapur në rrethin e Korçës,

objekte vjedhesh kanë qënë kryesisht vjedhja e banesave që janë të pa banuara pasi pronarët ndodhen në emigracion, por nuk kanë munguar edhe rastet e vjedhjeve të tjera.

Çështjet penale për të cilat është shpallur moskompetenca, zënë në përqindje pothuajse të njëjtën vlerë me një vit më parë.

III/1. Mosfillimet e procedimeve penale gjatë vitit 2015.

Gjatë vitit 2015 është vendosur mosfillimi i procedimit për 604 kallëzime penale.

Është vendosur mosfillimi i procedimit penal në të shumtën e rasteve për veprat penale të “Kanosjes” neni 84 i K.P, *Dëmtimeve të tjera me dashje* neni 90 K.P për shkak të pasojës dhe kategorisë së dëmtimeve mjeko-ligjore, “Shkaktimit të vetëvrasjes” neni 99 i K.P, “Falsifikimit të dokumentave” neni 186 i K.P dhe “Shpërdorimit të detyrës” neni 248 i K.P, për “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor” neni 290 K.P, për veprën penale të “Shkatërrimit të pronës” neni 150 K.P për shkak të vlerës së dëmit apo shkakut të dëmit, për veprën penale të “Mashttrimit” neni 143 K.P për shkak të ekzistencës së një marrëdhënie kontraktore civile, etj.

Më konkretisht, treguesit e dosjeve të mosfillimit të procedimeve penale në lidhje me veprat penale të trajtuara janë si më poshtë:

	Viti 2014	Viti 2015
Neni për të cilin janë trajtuar	Numri i mosfillimeve	Numri i mosfillimeve
Per nenin 186	20	21
Per nenin 90	57	40
Per nenin 248	25	28
Per nenin 150	56	41
Per nenin 143	38	21
Per nenin 84	77	52
Për nenin 290	58	47
Për nenin 99	96	92
Për nenin 199/a	8	12
Për nenin 200	19	14
Të tjera	243	236

Nga krahasimi i treguesve të punës gjatë vitit 2015 me ato të vitit 2014, rezulton se ka një përpjestim të drejtë midis totalit të materialeve kallzuese të rregjistruara dhe numrit të rasteve për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal në të tre vitet të cilat janë marrë për krahasim.

Nga totali i vendimeve për mosfillimin e procedimit penal, janë kundërshtuar vendimet në gjykatë për 29 vendime mosfillimi. Referuar vendimarrjes së gjykatës për 9 raste gjykata ka pranuar ankimin duke urdhëruar fillimin e procedimit penal, në 13 raste ka lënë në fuqi vendimin e mosfillimit dhe 7 raste janë ende në gjykim.

Në lidhje me fazën e verifikimit të materialeve referuese e kallëzuese, konstatohet fakti që ka raste që verifikimi zgjat tej afatit të përcaktuar në Urdhërin e Prokurorit të Përgjithshëm. Në tejkalimin e këtij afati ndikojnë vonesat në përgjigjet për aktet e ekspertimit dhe vonesat në përgjigjet e informacioneve të kërkuara nga institucione të ndryshme. Konstatohet se numri më i madh i mosfillimeve është marrë për materialet kallzuese të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 99 i K.Penal. Një vepër penale mjaft e përhapur në Rrethin e Korçës, e ndikuar kjo nga faktorë jo vetëm social-ekonomikë, por edhe shkaqe të shëndetit. Gjithashtu një numër të konsiderueshëm vendime mosfillimi janë marrë për veprën penale të parashikuar nga neni 290 i K.Penal, (kur nuk kanë qënë pasojat që parashikon ana objektive e dispozitës). Në të gjitha këto raste, kopje e vendimit i është dërguar Kom.Pol.Korçë, seksionit të qarkullimit rrugor, me qëllim marrjen e masave përkatëse administrative.

III/2. Çështjet penale të pushuara gjatë vitit 2015.

Rezulton se gjatë vitit 2015 është vendosur pushimi për 379 çështje penale, të cilat në krahasim me numrin e çështjeve të pushuara në vitin 2014 përbëjnë 47 çështje më pak. Pra rezulton një trend në rënie i çështjeve të pushuara në vlerën 17% që është në përpjestim të drejtë me rënien e numrit të procedimeve. Veprat penale për të cilat është vendosur pushimi i procedimeve janë pak a shumë ato për të cilat është vendosur mosfillimi, ndërsa për shkaqet mund të themi se ato përfshijnë rastet e parashikuara më së shumti prej gërmave “b”, “dh” dhe “d” të nenit 328/1 të K.Pr.Penale.

Më konkretisht, treguesit e çështjeve penale të pushuara, në mënyrë krahasimore me vitin 2015, janë si më poshtë :

	2013	2014	2015
Për nenin 186	17	16	10
Për nenin 89	43	16	43
Për nenin 248	10	10	23
Për nenin 199/a	10	21	12
Për nenin 275	25	30	19
Për nenin 143	12	9	16
Për nenin 180	1	2	13
Për nenin 190	5	13	22
Për nenin 84	27	9	2
Për nenin 99	35	9	3
Për nenin 197	4	32	15
Për nenin 205	5	59	18
Për nenin 290	22	17	7
Për nenin 283	23	10	8
Të tjera	128	173	168

Për sa i përket çështjeve të pushuara, janë ankimuar në Gjykatë 41 vendime pushimi, nga të cilat Gjykata në 10 raste ka prishur vendimin e pushimit duke lënë si detyrë kryerjen e veprimeve hetimore, në 27 raste ka ngelur në fuqi vendimi i pushimit dhe 4 raste, janë ende në Gjykim.

III/3. Çështje penale të dërguara për gjykim gjatë vitit 2015.

Gjatë vitit 2015 janë dërguar për gjykim 615 procedime penale krahasuar me 776 procedime të dërguara në gjyq në vitin 2014. Një rënie e tillë është pasojë e numërit më të vogël të kallzimeve penale të regjistruara. Me rëndësiparaqitet fakti që çështjet e dërguara në gjyq kapin rreth 41% të numrit të përgjithshëm të procedimeve penale të regjistruara. Tek çështjet e dërguara për gjykim numrin më të madh e zënë ato për veprën penale të parashikuar nga neni 134 i K.P. “Vjedhja”, - 87 procedime me 101 të pandehur, nga të cilët 43 me masë sigurimi “arrest në burg”. Veprat penale të parashikuar nga neni 291 i K.P. “Drejtimi i automjeteve në gjëndje të dehur apo pa dëshmi” – 94 çështje me 97 të pandehur nga të cilët 18 me arrest në burg, kanë një rënie rreth 40% nga viti i kaluar. Po kështu dhe veprat penale “Vjedhja e energjisë elektrike apo impulseve telefonike” neni 137 i K.P, 20 procedime me 20 të pandehur, 2 me masë sigurimi “arrest në burg”, kanë një rënie prej 50%. Mbetet ende i lartë numëri i çështjeve penale të dërguara në gjyq për dhunë në familje, që mbeten në numër të pandryshuara krahasuar me vitin 2014.

Treguesit e çështjeve penale të dërguara për gjykim janë si më poshtë:

	Numri i çështjeve të dërguara për gjykim 2014	Numri i çështjeve të dërguara për gjykim 2015
Për nenin 134	125 – 172 të pandehur – 102 a.burg	87-101 të pandehur -43 a.burg
Për nenin 89	24 – 35 të pandehur	22-37 të pandehur
Për nenin 88	10 - 15 të pandehur – 10 a.burg	8 - 10 të pandehur – 7 a.burg
Për nenin 199/a	42 – 42 të pandehur	7-7 të pandehur
Për nenin 186	8 – 13 të pandehur	12-29 të pandehur – 5 a burg
Për nenin 248	8 – 12 të pandehur – 2 a burg	7-11 të pandehur
Për nenin 259	1 - 1 të pandehur	2-3 të pandehuri -1 a.burg
Për nenin 130/a	58 – 63 të pandehur – 34 a.burg	57-64 të pandehur-22 a. burg
Për nenin 197	66 – 75 të pandehur	25-27 të pandehur
Për nenin 290	14 - 14 të pandehur – 4 a.burg	25-30 të pandehur-5 a.burg
Për nenin 291	138 - 138 të pandehur – 10 a.burg	94-97 të pandehur-18 a.burg
Për nenin 283	22 – 49 të pandehur – 44 a.burg	16-31 të pandehur-21 a.burg
Për nenin 284	1 - 1 të pandehur – 1 a.burg	5-6 të pandehur-4 a.burg
Për nenin 297	37 – 41 te pandehur – 1 a burg	18- 18 të pandehur
Për nenin 278	13 – 21 të pandehur – 13 a.burg	12-14 të pandehur -8 a.burg
Për nenin 79	6 - 7 të pandehur – 6 a.burg	-

Për nenin 78	1 - 1 të pandehur – 1 a.burg	1-1 të pandehur -1a.burg
Për nenin 76	3 – 3 të pandehur – 3 a.burg	5 – 5te pandehur – 3 a burg
Për nenin 139-140 141	2 – 5 të pandehur – 5 a.burg	8- 8 të pandehur -4 a.burg
Për nenin 181	1 - 1 të pandehur	4- 8 të pandehur
Për nenet 171/174	4 - 8 të pandehur – 3 a burg	16-28 të pandehur – 1 a burg
Për nenin 137	41 - 47 të pandehur- 9 a.burg	20-20 të pandehur -2 a. burg
Për nenin 135	2 - 5 të pandehur - 1 a.burg	3-3 të pandehur
Të tjera	157	161

Duke qënë se disa prej veprave penale të mësipërme, kanë qënë fenomen shqetësues në rreth, janë bërë të gjitha përpjekjet në bashkëpunim edhe me policinë gjyqësore, për t'i kushtuar rëndësinë e duhur çështjeve penale që kanë lidhje me veprat e mësipërme, me qëllim që hetimet paraprake në lidhje me këto vepra të jenë sa më të plota, të kryhen në afate optimale dhe të rritet zbulueshmëria për të vënë para përgjegjësisë penale autorët të cilët janë burim rreziku për shoqërinë.

III/4. Çështjet penale të pezulluara gjatë vitit 2015

Rezulton se gjatë vitit 2015 janë pezulluar për moszbulim të autorëve të veprës penale 502 çështje penale, që në krahasim me numrin e çështjeve të pezulluara në vitin 2014 rezulton 15,6% më pak si dhe përbën 33% të çështjeve të përfunduara gjatë vitit 2015.

Më konkretisht, treguesit e çështjeve penale të pezulluara në lidhje me veprat penale të trajtuara në to paraqiten si më poshtë;

Vepra penale	Viti 2014	Viti 2015
Kreu II	13	9
Për nenin 134 të K.P.	482	389
Kreu III te tjera	72	69
Kreu IV	2	1
Kreu VIII	25	34

Nga të dhënat e mësipërme vihet re se numri i çështjeve penale të rregjistruara dhe të pezulluara për nenin 134 të Kodit Penal është i konsiderueshëm dhe rritja e kësaj figure bazohet në faktorë socialë dhe ekonomikë.

Një përqindje të konsiderueshme mbas çështjeve të pezulluara për vjedhje pa autor, zënë edhe çështjet penale të pezulluara për veprat penale që lidhen me shkatërrimin e pronës.

Treguesit e çështjeve, ndonëse në zbritje të çështjeve të pezulluara, janë të lidhura ngushtësisht me cilësinë e materialeve referues dhe posaçërisht me veprimet e para hetimore. Për të përmirësuar këta tregues duhet një kujdes i veçantë nga policia gjyqësore në këqyrjet e vendit

të ngjarjes. Duhet gjetur rrugë e mënyra të ndryshme, për të afruar informacionin e nevojshëm për autorët dhe gjetjen e mjeteve e metodave ligjore për të kthyer në prova të gjitha të dhënat që administron policia gjyqësore për rastin.

Në shumë raste, veprimet e para hetimore, si kqyrja e vendit të ngjarjes, zbulimi, fiksimi dhe marrja e gjurmëve dhe provave materiale që kanë lidhje me zbulimin e mekanizmit dhe autorëve, kanë qenë jo të plota dhe të kryera në mënyrë jo profesionale. Kryerja e ketyre veprimeve me përpikmëri dhe përgjegjësi do të çonte në hetimin e plotë të ngjarjes dhe zbulimin dhe vënien para përgjegjësisë penale të autorëve të kryerjes së veprës.

III/5. Çështjet penale të transferuara gjatë vitit 2015.

Rezulton se gjatë vitit 2015 është shpallur moskompetenca për 19 procedime penale.

Vendimet në lidhje me shpalljen e moskompetences dhe kalimin e akteve kanë qënë objekt i konfliktit për kompetencë, tek Prokurori i Përgjithshëm, në 1 rast ku vendimet e marra prej Prokurorisë së Korçës është gjetur i pabazuar dhe dosja është rikthyer për kompetencë në këtë prokurori.

IV. Treguesit e të pandehurëve

Gjatë vitit 2015, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, janë marrë 774 shtetas në cilësinë e të pandehurit dhe 455 shtetas në cilësinë e personit nën hetim, nga të cilët 766 shtetas janë dërguar për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Më konkretisht, treguesit e të pandehurve për vitet 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

Viti	Totali	Të pandehur	P.në hetim	Pushuar	Transferuar	Push. Het. Pezulluar Çështja	Gjykim
2015	1219	774-186 a.burg	455	5+209 p.hetim	15 p.hetim	50 p.hetim	766-183 a.burg
2014	1508	956-286- arrest	552	1+255 p.hetim	10 p.hetim	30 p.hetim	953-288 a.burg
2013	1090	587- 179 arrest	503	2 + 212 p.hetim	1 p.hetim	15 p.hetim	585- 175 a.burg

V. Treguesit e masave të sigurimit.



Gjatë vitit 2015, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë janë referuar në funksion të procedimeve penale të regjistruara 454 raste të personave të arrestuar në flagrancë apo ndaluar.

Për personat e arrestuar dhe ndaluar, nga ana e prokurorëve është urdhëruar lirim i menjëhershëm në 1 raste, dhe në 453 raste janë dërguar aktet në gjykatë për vleftësim arresti në flagrancë/ndalimi. Në 2 raste Gjykata e ka vlerësuar arresin e paligjshëm. Është kërkuar në 267 raste caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg” dhe kërkesë e pranuar nga gjykata në 240 raste. Për rastet e tjera gjykata ka caktuar si masë sigurimi “Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”, ose “Arrest në shtëpi”.

Treguesit e masave të sigurimit, referuar edhe qëndrimeve që ka mbajtur gjykata, flasin për një politikë të drejtë të ndjekur nga prokuroria në lidhje me caktimin e masave të sigurimit. Kujdes i veçantë është treguar në rastet kur personat e dyshuar kanë qënë të mitur, pasi në lidhje me ta, veç moshës janë mbajtur parasysh edhe rrethana të tjera shoqërore e sociale për të qënë sa më objektiv e të kujdesshëm në caktimin e masës së sigurimit. Masa e sigurimit “arrest në burg”, ndaj të miturve është kërkuar vetëm në rastin e veprave penale të rënda, ose në rastin kur ata janë përsëritës në kryerjen e veprave penale.

Treguesit e masave të sigurimit janë të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

Totali i arrestimeve/ndalimeve	Lirim i menjëhershëm Neni 257	Kërkesa e prokurorisë Neni 258	Vendimi i gjykatës Neni 259
454	1	453	453
Vleftësime të ligjshme			451
Vleftësime të paligjshme			2

Arrest në burg		254	219
Arrest me afat		8	8
Arrest në shtëpi		4	12
Detyrim paraqitje		180	206
Garanci pasurore		4	5
Arrest në mungesë		1	1


VI. Treguesit e mënyrës së përfundimit të gjyqimit për çështjet penale të trajtuara gjatë vitit 2015.

Gjatë vitit 2015, nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë janë përfunduar gjykimet e 719 çështjeve penale me 877 të pandehur.

Më konkretisht treguesit e gjyqimit të çështjeve penale janë si më poshtë;

Totali i çështjeve të gjykuara	Gjykim i drejtëpërdrejtë	Gjykim i shkurtuar	Gjykim i zakonshëm	Gjykim në mungesë
719 - 877 të pandehur	35 –35	579 – 688	105 – 154	12 - 12

Treguesit e mësipërm paraqiten në grafikë që vijon:



Nga totali i çështjeve të gjykuara, nga ana e organit të prokurorisë gjatë vitit 2015, është kërkuar dënimi i të pandehurve me gjobë në 225 raste, tërheqje aktesh në 3 raste, pushim çështje në 14 raste, në rastet e tjera është kërkuar dënim me burgim, në 1 raste burgim i përjetshëm, në 8 raste ulje dënimi nën minimum. Janë gjithsej 140 raste me kërkesë për dënim me kusht, të cilat i referohen më së shumti rasteve me të pandehur të mitur, ose me të pandehura femra, për arsye të politikës së ndjekur për këtë kategori personash.

Të dhënat paraqiten në tabelën si më poshtë:

Llojet e dënimeve	Kërkesa e prokurorisë	Vendimi i gjykatës
Dënim me gjobë	225	257
Dënim me burgim (minimal)	175	143
Dënim me burgim (mesatar)	311	222
Dënim me burgim (maksimal)		
Paraburgim		
Ulje dënimi nën minimum	8	29
Pezullim ekzekutimi dënimi	140	173
Burgim të përjetshëm	1	1
Tërheqje aktesh	3	2
Pushim çështje	14	17
Pafajësi		33

Gjatë vitit 2015 pafajësitë janë marrë për veprat penale të mëposhtme:

- | | |
|--------------------------------|--------------------------------|
| - Për nenin 197 - 4 pandehur | - Për nenin 27 - 1 pandehur |
| - Për nenin 321 - 1 pandehur | - Për nenin 186 - 6 pandehur |
| - Për nenin 186/a - 1 pandehur | - Për nenin 248 - 1 pandehur |
| - Për nenin 283 - 5 pandehur | - Për nenin 236 - 3 pandehur |
| - Për nenin 88 - 1 pandehur | - Për nenin 134 - 2 pandehur |
| - Për nenin 150 - 2 pandehur | - Për nenin 243 - 1 pandehur |
| - Për nenin 89 - 1 pandehur | - Për nenin 84 - 1 pandehur |
| - Për nenin 288/a - 1 pandehur | - Për nenin 130/a - 2 pandehur |
| - | |

Për shumë nga rastet e pafajësisë ne vazhdojmë të mbetemi konsequentë në qëndrimet tona para gjykatës dhe për të gjitha rastet është mbajtur qëndrimi ligjor duke ankimuar vendimet e gjykatës. Nga ankimet e paraqitura në Gjykatën e Apelit, kjo e fundit ka pranuar apelet vetëm në 4 raste, nga të cilat në 3 raste është ndryshuar vendimi, duke u disponuar sipas kërtimeve të prokurorit dhe në një rast është prishur vendimi dhe çështja është kthyer për rigjykim në shkallë të parë.

VII. Shpejtësia në hetime dhe zgjatja e afatit të hetimeve paraprake gjatë vitit 2015.

Gjatë vitit 2015 rezulton se për çështjet që janë trajtuar nga organi i prokurorisë janë marrë zgjatje e afatit të hetimeve paraprake për 101 çështje me 74 persona në hetim apo të pandehur nga të cilët, 27 kanë qenë me masë sigurimi “arrest në burg”. Nga këto zgjatje afati, 95 janë bërë vetëm me 3 (tre) muaj, 3 janë bërë nga 3-6 muaj, dhe 1 rast deri në 1(një) vit.

Rrethanat që kanë çuar në zgjatje të afatit të hetimeve lidhen kryesisht me vonesat në administrimin e akteve nga Drejtoria e Policisë Shkencore kryesisht ato biokimike pranë D.P.SH.Tiranë dhe informacioneve të tjera nga institucionet.

Si shkak specifik për vitin 2015, përsa i përket zgjatjes së afatit të hetimeve, renditet edhe vonesat në kryerjen e ekspertimeve kryesisht ato biokimike pranë D.P.SH.Tiranë.

VIII. Shfuqizimet e akteve të prokurorëve gjatë vitit 2015.

Gjatë vitit 2015 rezultojnë të jenë shfuqizuar nga prokurori më i lartë 20 çështje penale, nga të cilat 19 janë shfuqizuar nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe 1 nga Prokurori i Përgjithshëm.

IX. Përgjimet

Rezulton që gjatë viti 2015 në funksion të procedimeve penale të janë nxjerrë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë 17 vendime për lejim përgjimi dhe zgjatje afati përgjimi. Njëkohësisht rezulton se prej prokurorëve janë nxjerrë 26 vendime për lejime përgjimi. Nga këto 14 kanë qënë vendime për përgjime telefonike , të cilat janë vleftësuar edhe në Gjykatë dhe 12 vendime për përgjime ambientale.

X. Apelimet e bëra nga Prokuroria gjatë vitit 2015.

Gjatë vitit 2015, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë ka paraqitur në gjykatë në total 99 ankime për vendime themeli të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe 6 apele kundërshtuese.

Gjatë vitit 2015 janë paraqitur 6 ankime kundër vendimeve për caktimin e masës së sigurimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Gjatë vitit 2015, nga ana e Prokurorisë së Apelit, janë autorizuar për përfaqësim Prokurorët pranë Gjykatës së Shkallës së Parë në 9 raste, në të gjitha këto raste nuk është pranuar apeli i prokurorit.

Për ushtrimin e të drejtës së ankimit është mbajtur parasysh Urdhëri i Prokurorit të Përgjithshëm. Kështu pjesa më e madhe e ankimeve janë për vendimet e pafajësisë së plotë apo të pjesshme të dhënë nga gjykata si dhe për rastet e ndryshimit të cilësimit të veprës penale. Gjithashtu është ushtruar e drejta e ankimit edhe në rastet kur ka patur diferenca midis sanksioneve të kërkuara nga prokurori me ato të vendosura nga gjykata.

Ka patur një bashkërendim të mirë të punës me Prokurorinë e Apelit Korçë në lidhje me problematikat e hasura gjatë gjykimit të çështjeve duke unifikuar qëndrimet dhe rakorduar praktikat për rastet e ngjashme.

XI. Ngarkesa e punës së Prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore gjatë vitit 2015.

Gjatë vitit 2015, nga prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë është përballuar një ngarkesë e konsiderueshme pune si në fazën e hetimeve paraprake dhe në gjykim.

Në tabelën e mëposhtme janë përmbledhur të dhënat e ngarkesës së prokurorëve në fazën e hetimeve paraprake dhe mënyrën e përfundimit të çështjeve prej tyre.

Nr .	Prokurori	Mosfill	Gjithsej Procedim e	Pezulluar r	Pushua r	Gjyqi t	Transf	Bashk	Nën Hetim
1	Irena Çunoti	64	162	44	31	62	5	6	20
2	D.Nure	54	190	53	45	48	2	5	42
3	D.Tafili	41	118	43	13	31	0	1	31
4	Dh.Theodhor i	43	169	26	62	50	3	3	28
5	E.Beqiri	51	120	19	20	41	1	3	39
6	E.Mustafaj	5	12	2	6	2	0	2	0
7	E Sadiku	8	60	5	21	29	0	3	5
8	E Shytiko	45	116	41	15	44	1	1	15
9	G.Stoja	72	169	44	30	50	0	2	45
10	I Bano	64	209	46	42	84	4	11	33
11	J. Kristo	56	184	65	26	54	0	2	41
12	N.Shipska	48	172	54	24	53	0	1	41
13	O Eminaj	41	181	41	40	57	2		41
14	O.Visi	12	33	19	4	10	0		

Referuar të dhënave të mësipërme rezulton se shumë prej prokurorëve kanë trajtuar gjatë fazës së hetimeve paraprake mbi 170 procedime penale. Për prokurorin E. Shytiko duhet të kemi parasysh se veç hetimit ka qënë i ngarkuar edhe me ekzekutimin e vendimeve penale.

Për vitin 2015 janë përfunduar në gjykim 719 çështje penale dhe 25 çështje që janë ndjekur drejtpërdrejt në gjykatë. Të ndara sipas prokurorëve, statistikën e çështjeve të gjykuara janë të pasqyruar në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Prokurori	Çështjet e gjykuara
1	Irena Çunoti	77
2	D.Nure	58
3	D.Tafili	24
4	Dh.Theodhori	51
5	E.Beqiri	36

Analiza vjetore e vitit 2015

6	E.Mustafaj	27
7	E Sadiku	32
8	E Shytko	54
9	G.Stoja	51
10	I Bano	88
11	J. Kristo	69
12	N.Shipska	69
13	O Eminaj	69
14	O.Visi	14
	TOTALI	719

Më i ngarkuar në gjykim ka qënë prokurori Ilia Bano i cili mbulon seksionin e të miturve në këtë prokurori, ngarkesë që vjen për faktin se procedimet penale në këtë seksion janë me autorë të identifikuar dhe pjesa më e madhe e tyre dërgohen për gjykim.

Gjatë vitit 2015 nga oficerët e policisë gjyqësore të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë, është përballuar një ngarkesë sipas të dhënave të pasqyruara më poshtë:

Nr	Of.Pol. Gjyqësore	Totali i çështjeve	Të përfunduara	Të mbartura
1	A.Malaveci	35	29	6
2	A.Xhetani	40	36	4
3	E.Tase	61	53	8
4	L.Civici	39	34	5
5	P.Note	60	49	11
6	S.Kokoneshi	55	43	12

Ashtu siç edhe rezulton nga të dhënat e mësipërme, oficerët e policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, gjatë vitit 2015 kanë patur një ngarkesë të konsiderueshme pune në fazën e hetimit paraprak.

Oficeri i Pol.Gjyqësore Piro Note ka mbuluar gjatë vitit 2015 seksionin e ekzekutimit të vendimeve penale, ky oficer pas caktimit si Of.Pol.Gjyqësore i NJPH, është zëvendësuar me Of. Pol.Gjyqësore Elion Tase.

XII Treguesit e ngarkesës për Seksionin e të Miturve gjatë vitit 2015.

Gjatë vitit 2015 Seksioni i të Miturve ka patur në përbërje të tij dy prokurorë dhe konkretisht prokurorët Ilia Bano dhe Irena Çunoti si dhe oficeren e policisë gjyqësore Stela Kokoneshi.

Seksioni i të Miturve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, siç dihet mbulon çështjet me të mitur edhe për juridiksionin e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec.

Në çështjet që ka trajtuar seksioni i të miturve kujdes i veçantë i është kushtuar caktimit të masave të sigurimit. Gjithashtu edhe në kërkesat për masë dënimi është mbajtur parasysh fakti se subjektet janë persona të mitur, dhe lloji dhe masa e dënimit të dhënë ka qënë gjithnjë e kushtëzuar nga ky fakt dhe sigurisht ka patur për bazë parashikimet ligjore për veprën e kryer. Qëndrim i ashpër është mbajtur për të miturit që kanë rezultuar përsëritës dhe për rastet kur vepra është kryer në rrethana të cilësuar.

Më konkretisht treguesit e ngarkesës së punës së Seksionit të të Miturve janë si më poshtë:

Viti	Mbartur në hetim	Regjistrua	Gjithësej	Pushuar hetimi apo çështja	Dërguar Gjyqit	Mbetur në hetim	Përfunduar Gjykimi
2013	8	50	58	11	43	4	41
2014	4	46	50	0	46	4	42
2015	4	41	45	9	31	5	39

X/2. Treguesit e ngarkesës për Njësinë e Përbashkët Hetimore Kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit gjatë vitit 2015.

Gjatë vitit 2015 në përbërje të Njesisë së Përbashkët Hetimore Korçë, kanë punuar 2 prokurorë, Drejtuesi i Njesisë, si dhe 2 oficerë të policisë gjyqësore të seksionit të Prokurorisë, një oficer i policisë gjyqësore i Drejtorisë së Tatimeve dhe një oficer i policisë gjyqësore i Drejtorisë së Doganave.

Gjatë tre mujorit të parë të vitit 2015 në Njësi kanë punuar Drejtuesi i Njesisë dhe Prokurorët Dhorina Theodhori, Elion Mustafaj, ndërsa në muajin Mars të vitit 2015 është larguar prokurori Elion Mustafaj, i cili është zëvendësuar me Prokurorin Olger Eminaj. Në muajin Shtator 2015, është transferuar Of.Pol.Gjyqësore Altin Xhetani, i cili është zëvendësuar me Of.Pol.Gjyqësore Piro Note.

Aktualisht struktura e NJPH hetimore, është e plotë, referuar parashikimeve të Memorandumit të Bashkëpunimit. Duke qënë se emrat e Of.Pol.Gjyqësore të NJPH nga Policia e shtetit nuk janë të përcaktuar, hetimi i çështjeve që ndiqen nga Njësia, janë hetuar nga oficerët e

policiisë gjyqësore pranë Sektorit Kundër Krimit Financiar, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë.

Për vitin 2015 nga ana e Njesisë së Përbashkët Hetimore ka pasur një ngarkesë pune të konsiderueshme, krahasuar me vitet e mëparshme, kështu gjatë vitit 2015, janë rregjistruar 70 % materiale më shumë se viti 2014 dhe pothuajse trefishi i materialeve që janë rregjistruar nga NJPH gjatë vitit 2013. Gjithashtu statistikën në lidhje me çështjet e ndjekura nga NJPH, kanë tregues pozitiv jo vetëm në aspektin sasior, por edhe atë cilësor.

Gjatë vitit 2015 nga NJPH-ja janë trajtuar në total 179 referime penale dhe kallëzime penale, prej të cilave janë rregjistruar 131 procedime penale të reja, si dhe është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 45 referime dhe kallëzime penale.

Për vitin 2015 numëri i kallëzimeve dhe referimeve penale është rritur në masën 70 % krahasuar me vitin 2014, që përkon me 70 kallëzime dhe referime penale më tepër, ndërsa numëri i procedimeve penale të reja është rritur në masën 45 % krahasuar me vitin 2014, që iu korespondon 43 procedime penale më tepër.

Rezulton se gjatë vitit 2015 janë hetuar gjithsej 187 procedime penale, janë përfunduar hetimet për 122 procedime penale, 61 janë dërguar për gjykim, është vendosur pushimi për 54 procedime penale, 4 procedime janë pezulluar, ndërsa 3 janë transferuar. Referuar këtyre të dhënave, sikurse shihet raporti midis çështjeve të dërguara në gjyq dhe atyre të pushuara është mjaft pozitiv, pasi numri i çështjeve të dërguara për gjykim përbën 50%, të totalit të çështjeve të hetuara.

Duke iu referuar këtyre të dhëna rezulton se në vitin 2015, janë hetuar 74 % më tepër procedime penale se më vitin 2014, që iu korespondon numëri prej 79 procedime penale më tepër, janë përfunduar hetimet për 80 % më tepër procedime penale krahasuar me vitin 2014, që iu korespondon numëri prej 54 procedime penale më tepër, si dhe janë dërguar për gjykim 91 % procedime penale më tepër krahasuar me vitin 2014, që i korespondon numëri prej 29 procedime penale më tepër sesa në vitin 2014.

Gjatë vitit 2015 kanë qënë në fazën e gjykimit gjithsej 68 çështje penale, me 110 të pandehur. Ka përfunduar gjykimi për 59 çështje penale, 56 prej tyre kanë përfunduar me vendim fajësie, që iu korespondojnë 69 persona të dënuar, ndërsa për 3 çështje penale është vendosur pafajësi dhe në një çështje, është vendosur pafajsi për njërin prej të pandehurve (pafajsi e pjesshme). Janë mbartur në gjykim për vitin 2016, gjithsej 9 procedime penale me 32 të pandehur.

Më konkretisht më poshtë po paraqesim të dhënat për secilin nga Prokurorët e NJPH, gjatë tre viteve të fundit në tabelat si më poshtë vijon;

Treguesit për vitin 2013:

Prokurorët	Referim	Kryesisht	Mosfilluar	Verifikim i kallzimeve ne ndjekje	Mbartur procedime	Procedime te reja	Totali i procedimeve ne Hetim	Pushim	Pezullim	Transferim	Gjykim	Totali perfunduar Hetimet	Mbartur ne Hetim	Mbartur ne Gjykim nga 2014	Gjithsej ne Gjykim	Perfunduar Gjykimi gjithsej procedime	Fajesi	Pafajesi ose Pushim Gjykimi	Mbartur ne gjykim per periudhen ne vazhdim
E. Sadiku	27	1	13	0	9	14	23	8	-	-	6	14	6	6	12	12	10	3	2
Dh.Theodhori	24	1	6	0	7	21	28	10	0	3	7	20	8	3	10	6	7	1	4
E. Mustafaj	24	0	4	0	0	20	20	1	-	2	1	4	16	-	1	-	-	-	1
Tot	75	2	23	0	16	55	71	19	-	5	14	38	30	9	23	18	17	4	7

Treguesit për vitin 2014:

Prokurorët	Referim	Kryesisht	Mosfilluar	Verifikim i kallzimeve ne ndjekje	Mbartur procedime nga 2013	Procedime te reja	Totali i procedimeve ne Hetim	Pushim	Pezullim	Transferim	Gjykim	Totali perfunduar Hetimet	Mbartur ne Hetim per periudhen ne vazhdim	Mbartur ne Gjykim nga 2013	Gjithsej ne Gjykim proc	Perfunduar Gjykimi gjithsej	Fajesi	Pafajesi ose Pushim Gjykimi	Mbartur ne gjykim per periudhen ne vazhdim
E. Sadiku	7	0	0	0	10	7	17	3	-	2	8	12	3	2	10	9	8	1	1
Dh.Theodhori	53	2	17	1	9	37	46	13	2	0	13	28	18	3	16	12	12	0	4
E. Mustafaj	49	1	6	1	11	44	55	17	1	1	11	28	27	-	11	7	6	1	4
Tot	109	3	23	2	30	88	108	33	3	3	32	68	48	5	37	28	26	2	9

Treguesit për vitin 2015:

Analiza vjetore e vitit 2015

Prokurorët	Referim	Kryesisht	Mosfilluar	Verifikim i kallzimeve ne	Mbartur procedime 2013-2014	Procedime te reja	Totali i procedimeve ne Hetim	Pushim	Pezullim	Transferim	Gjykim	Totali perfunduar Hetimet	Mbartur ne Hetim	Mbartur ne Gjykim nga 2014	Gjithsej ne Gjykim proc	Perfunduar Gjykimi gjithsej procedime	Fajesi	Pafajesi ose Pushim Gjykimi	Mbartur ne gjykim per pertudhen ne vazhdim
E. Sadi ku	31	2	9	0	24	24	48	16	1	-	25	42	6	3	28	24	23	2	4
Dh. The odho ri	95	1	24	0	31	72	103	32	3	2	30	67	36	4	34	29	27	2	5
O.E mina j	50	0	12	3	1	35	36	6	-	1	6	13	23	-	6	6	6	-	0
Tot	176	3	45	3	56	131	187	54	4	3	61	122	65	7	68	59	56	4	9

Nga ana e Of.Pol.Gjyqësore të Seksionit të Prokurorisë, është përballuar një volum i konsiderueshëm pune, duke marrë në konsideratë që pjesa më e madhe e çështjeve penale kanë pasur shtrirje në kohë dhe shumë veprime hetimore për tu kryer.

Një numër të konsiderueshëm çështjesh penale janë hetuar edhe nga Of.Pol Gjyqësore i Drejtorisë së Tatimeve, i cili duhet thënë se përveç çështjeve penale të referuara nga Drejtoria e Tatimeve, ka hetuar edhe çështje të referuara nga policia për nenet 180-183 të K.Penal.

Për sa i përket Of.Pol.Gjyqësore të Drejtorisë së Doganave, megjithse nga ky institucion nuk është referuar asnjë material, ky oficer është angazhuar me hetimin e çështjeve penale të referuara nga Policia për nenet 171-179/a të K.Penal.

Duke iu referuar burimit të njoftimeve të veprave penale të regjistruara që janë në kompetencë të Njesisë së Përbashkët Hetimore, vihet re se gjatë vitit 2015 numërin më të madh të rasteve të referuar e zë Policia e Shtetit, me 109 raste të referuara, më pas vijnë kallzimet nga shtetasit me 40 raste, Drejtoria e Përgjithshme e tatimeve me 7 raste të referuara, ILDKPI me 5 raste të referuara, KLSH me 3 raste të referuara dhe 16 raste janë referuar nga institucione të tjera. Ajo që bie në sy dukshëm në lidhje me burimet e referimit, është fakti se, megjithëse Korça, ka në juridiksionin e saj 2 pika doganore (Kapshticë dhe Goricë), numri i rasteve të referuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është 0. Gjithashtu edhe numri i rasteve që kanë pasur si burim FIU është 0.

Më poshtë po paraqesim tabelën në lidhje me burimet e referimit:

Burimi i referimit te materialeve Hetimore	Referuar	Mosfillim	Vazhdon verifikimi	Rregjistruar procedimi
Kryesisht	3	0	0	3
Pol.Shtetit	105	13	2	90
KLSH	3			3
ILDKP	5			5
FIU				
SHISH				
D.P.T	7			7
D.P.D	0			0
Te tjera	16	8	0	8
Kallzime	40	24	1	15
TOTAL	179	45	3	131

Duhet theksuar se megjithse rastet e referuara nga Policia e Shtetit, zënë pjesën dërmuese të rasteve të referuara, numri i çështjeve të ndjekura me hetim proaktiv, është shumë i vogël. Mendojmë që në këtë drejtim mund të bëhet më shumë, duke marrë parasysh edhe faktin janë disa procedime që janë filluar kryesisht bazuar në faktet e shfaqura në emisionet investigative, çështje të cilat me një bashkpunim më të mirë midis agjensive ligjzbatuese, mund të ishin filluar para se çështjet të shfaqeshin në emisione televizive.

Në lidhje me bashkëpunimin me Instiucionet Nënshkruese të Memorandumit të Bashkpunimit, është mbajtur kontakt i vazhdueshëm dhe janë organizuar në vazhdimësi takime me Drejtuesit e Policisë, për të analizuar probleme të përgjithshme dhe për të rritur efikasitetin në drejtim të hetimit të këtyre veprave penale dhe numrin e çështjeve me hetim proaktiv. Ju është kërkuar në mënyrë të përsëritur rritja e performancës nga ana e sektorit kundër krimit ekonomiko-financiar, marrja dhe përpunimi i informacioneve, me qëllim rregjistrimin e procedimeve penale.

Për sa i përket marrdhënieve me SHISH, janë marrë kontakte të vazhdueshme me kryetarin e Degës Korçë, është përcjellë nga ky institucion një informacion, i cili më pas i është përcjellë Drejtorisë së Policisë, për të bërë verifikimet e nevojshme dhe për ta kthyer në një material referues, pasi siç dihet materialet e e ardhura nga shërbimi, nuk mund të shërbenë për rregjistrimin e procedimeve penale. Ende nuk kemi një material referues për këtë informacion. Gjithsesi duhet thënë se duhet rritur bashkpunimi midis SHISH dhe Policisë, në funksion të nisjes së hetimeve proaktive.

Është e rëndësishme të theksohet se kemi patur një bashkpunim shumë të mirë me Drejtorinë e Hetimit Tatimor Tiranë, si rezultat i të cilit, është arritur të finalizohet dërgimi në gjyq i 12 të pandehurve (8 persona fizikë dhe 4 persona juridikë), për veprat penale të “Krijimit të skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar” dhe “Fshehjes së të ardhurave”, “Fallsifikimit të dokumentave” (nga personi që e ka për detyrë) dhe “Shpërdorimit të Detyrës” të parashikuar nga nenet 144/a dhe 180/3, 186/3 dhe 248 të K.Penal.

Në të gjitha rastet, kur nga vepra penale kanë ardhur pasoja materiale për shtetin, kopje e kërkesës për gjykim i është dërguar edhe Zyrës Vendore të Avokaturës së Shtetit Korçë.

Rastet e procedimeve penale të pushuara kanë qënë kryesisht për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal. Kjo për shkak se në mjaft raste nuk kemi qënë para elementëve të kësaj vepre penale. Gjithashtu në disa raste nuk janë provuar elementët e kësaj vepre penale, për shkak të veprimeve hetimore që kryhen shumë kohë pasi ka ndodhur fakti objekt hetimi, si dhe për vetë karakterin që ka kjo vepër penale e cila referohet sa herë që nuk gjenden elementë të ndonjë vepre tjetër penale. Gjithashtu, është pikërisht kjo vepër penale për të cilën është vendosur më së shumti mosfillimi i procedimit penal.

Gjithsesi vlen të theksohet se nga të gjitha vendimet e pushimit asnjë prej tyre nuk është ankimuar në Gjykatë. Gjithashtu nga vendimet e mosfillimit janë ankimuar në Gjykatë 4 vendime mosfillimi, nga të cilat Gjykata ka lënë në fuqi vendimin e prokurorit në tre raste dhe një rast është në proces gjykimi.

Në lidhje me kategorinë e veprave penale të hetuara:

Numrin më të madh të veprave penale të hetuara e zënë veprat penale të parashikuara nga nenet 248-258 të K.Penal. Gjatë vitit 2015 janë hetuar gjithsej 77 procedime penale, në 26 raste është vendosur pushimi i çështjes, 2 procedime penale janë pezulluar, ndërsa 19 të pandehur janë dërguar për gjykim. Gjatë kësaj periudhe janë dënuar për këto vepra penale gjithsej 12 të pandehur, është deklaruar i pafajshëm 1(një) i pandehur, 6 të pandehur janë mbartur për gjykim në vitin 2016.

Për veprat penale të parashikuara nga nenet 180-183, janë hetuar gjithsej 27 procedime penale, nga të cilat 9 procedime penale janë pushuar, 1 procedim penal është pezulluar dhe janë dërguar për gjykim 21 të pandehur, 16 prej tyre janë deklaruar fajtorë nga gjykata, 5 të pandehur, vijnë në gjykim dhe nuk ka asnjë pafajsi për këtë kategori veprash penale.

Për veprat penale të parashikuara nga nenet 186-191, janë hetuar gjithsej 26 procedime penale, nga të cilat janë pushuar 3, është pezulluar 1 procedim penal, 1 procedim penal është transferuar dhe janë dërguar për gjykim 14 procedime penale, janë dënuar 10 të pandehur dhe është marrë pafajsi për 8 prej tyre (sqarojmë se 5 të pandehur kanë qënë në një çështje penale).

Për veprën penale, të parashikuar nga neni 287 i K.Penal, gjatë vitit 2015, janë hetuar 21 procedime penale. Nga të cilat 11 prej tyre janë pushuar dhe 10 prej tyre janë nën hetim. Një numër relativisht i lartë duke ju referuar numrit të përgjithshëm të procedimeve penale të hetuara nga NJPH. Gjithsesi duhet theksuar se një pjesë e mirë e këtyre procedimeve penale, mund edhe të mos rregjistroheshin, pasi materialet referuese kanë qënë jo të plota, referuar në indicje dhe një pjesë e mirë kanë qënë të bazuar vetëm në faktin e mosdeklarimit në kufi të të hollave gjatë vitit 2013. Sqarojmë se një pjesë e këtyre procedimeve janë trashëguar edhe nga viti 2014 (6 të tilla).

Një problem shqetësues që ka të bëjë me këtë kategori veprash penale, është vonesa në kthimin e përgjigjeve nga autoritet kompetente, të cilave ju është kërkuar ndihmë juridike. Aktualisht janë dy procedime penale të rregjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni

287 i K.Penal, për të cilat është vendosur edhe sekuestro preventive nga Gjykata, të cilat janë në limitet e afatit të përgjithshëm (2 vjeçar), të hetimit.

Për veprat penale në fushën e Korrupsionit, të parashikuara nga nenet 244, 245, 245/1 dhe 259, janë hetuar gjithsej 16 procedime penale, nga të cilat është pushuar 1 procedim penal, janë dërguar për gjykim 10 procedime penale, janë dënuar 10 të pandehur dhe është në proces gjykimi një i pandehur.

Lidhur me veprën penale të parashikuar nga neni 259 i K.Penal është për tu përmëndur se referimet penale lidhur me këto vepra penale kanë qënë të pakta dhe me një nivel të ulët të dhënash. Nga ana jonë në të gjitha rastet këto referime penale janë rregjistruar si procedime penale, si dhe janë autorizuar përgjime në vënde publike dhe private, duke u hetuar rastet e paraqitura me hetime proaktive. Në këtë drejtim kërkohet më shumë nga ana e Policisë dhe një bashkëpunim më i ngushtë me strukturat e shërbimit.

Gjatë vitit 2015 janë dërguar për gjykim persona që kanë ushtruar funksionet publike më të larta në Institucionet vendore të Qarkut Korçë. Konkretisht, është dërguar për gjykim 1 çështje penale më të pandehur të zgjedhur vendorë (kryetari i Komunës Lekas), 1 çështje penale me të pandehur Drejtorin e Shërbimit Pyjor Korçë, shefin e financës, 3 shefa sektorësh dhe disa specialistë, 1 çështje penale me të pandehur ish Drejtorin e IEVP Korçë,

Në fazën e gjyimit për vitin 2015 janë deklaruar fajtor nga Gjykata, ish Drejtori i Policisë për Kufirin dhe Migracionin, ish Kryetari i Komunës Lekas, një shef sektori dhe një specialist i Drejtorisë Rajonale të Transporteve Korçë, si dhe punonjës të tjerë në nivelin e specialistit në institucionet shtetërore vendore të Qarkut Korçë.

Gjithashtu, është edhe për tu përmëndur fakti se gjatë vitit 2015 nuk ka pasur asnjë hetim proaktiv të filluar nga policia gjyqësore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Tiranë, ndaj ndonjë funksionari publik në institucionet vendore të Qarkut Korçë. Gjithashtu, shpesh është e nevojshme prania e strukturës operacionale, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për të realizuar vëzhgime, përgjime apo veprime simuluese në rastet e hetimit proaktiv.

Është e nevojshme që shërbimet e policisë gjyqësore të kenë një rol më aktiv në drejtim të mbledhjes dhe përpunimit të informacionit me iniciativën e tyre për vepra penale në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit, si dhe në drejtim të mbledhjes së të dhënave të nevojshme me qëllim fillimin e hetimeve proaktive, të cilat me shumë më pak veprime hetimore, me një ndjekje të vazhdueshme, në pjesën më të madhe të rasteve finalizohen me sukses, kanë efekt parandalues dhe rrisin në mënyrë të ndjeshme besimin e publikut.

XII. Ekzekutimet e vendimeve penale gjatë vitit 2015.

Në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë, për ekzekutimin e vendimeve penale gjatë vitit 2015 ka funksionuar seksioni përkatës ku janë ngarkuar prokurori Edmond Shytko, dhe o.p.gj. Piro Note.

Gjatë vitit 2015 rezulton se janë ekzekutuar në total 1014 vendime gjyqësore, të formës së prerë. Nga këto 403 urdhëra janë nxjerrë për ekzekutimin e vendimeve me burgim dhe 321 për ekzekutimin e dënimeve me gjobë dhe 242 për dënime alternative, dhe 35 urdhëra i përkasin vendimeve në lidhje me shuarje dënimi, shpenzimet gjyqësore, bashkime dënimesh, zëvendësim gjobe me burg, etj.

Në total gjatë këtij viti janë ekzekutuar 576 urdhëra ekzekutimi të vendimeve penale e konkretisht 299 urdhëra për dënime me burgim, 41 urdhëra për dënime me gjobë, 224 urdhëra ekzekutimi të vendimeve penale që përmbajnë dënime alternative dhe 35 urdhëra ekzekutimi të vendimeve në lidhje me shpenzimet gjyqësore, etj.. Po kështu, rezulton se nuk janë ekzekutuar nga institucionet përkaëse (Komisariari i Policisë, Zyra e Përmbarrimit etj.) 104 urdhëra ekzekutimi me burg dhe 280 për dënime me gjobë dhe 18 dënime alternative.

Në lidhje me dënimet alternative, për të cilat të dënuarit nuk kanë zbatuar vendimin e gjykatës, duke mos u paraqitur prane Zyrës Vendore të Sherbimit të Provës, apo gjatë kohës së provës kanë kryer një vepër tjetër penale, Seksioni i ekzekutiveve i është drejtuar Gjykarës për revokim e dënimit alternativ të dhëne në 33 raste. Nga Këto 32 raste janë pranuar dhe 1 rast nuk është pranuar dhe është bërë ankim.

Në fushën e ekzekutimit të vendimeve penale një prej problemeve është mungesa e adresës të saktë të të dënuarve.

Vështirësi ka patur gjatë fazës së ekzekutimit ndjekja e përmbushjes së dënimit alternativ që kanë të bëjnë me shkollimin, punësimin, moslargimin nga vendi i banimit, mospërdorimin e pijes alkolike apo lendëve narkotike, mosshoqërimi me persona të dënuar etj. Ndjekja e kësaj faze ekzekutimi kërkon një bashkëpunim dhe bashkërendim të ngushtë të punës midis Shërbimit të Provës, Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë.

XIII. Aktiviteti i zyrës së financës për vitin 2015

Aktiviteti i zyrës së financës është i lidhur drejtpërdrejt me mbarëvajtjen e punës së prokurorisë dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore gjatë një procedimi të rregullt penal.

Zyra e financës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë trashëgon prej vitesh një borxh financiar në lidhje me pagesat e ekspertëve, avokatëve dhe përkthyesve. Gjatë vitit 2015, ky detyrimi total (i mbartur dhe i krijuar gjatë vitit) ka qënë në shumën 4,447,835 leke. Është arritur të shlyhet një shumë prej 4,164,335 lekë dhe është mbartur për vitin 2016 një borxh prej 283,500 lekë.

Për detyrimet e prapambetura, që ju perkasin ekspertimeve mjeko- ligjore dhe akteteve të ekspertizave të mbrojtjes kundër zjarrit, nuk janë kryer pagesa dhe vlera e borxhit mbartur per vitin 2016 është 11,809,349 lekë për ekspertimet mjeko/ligjore dhe 629,800 lekë per aktet e PMNZHS-së (mbrojtjes kundër zjarrit).

XIV. Marrëdhëniet juridiksionale me jashtë gjatë vitit 2015.

Gjatë vitit 2015, rezulton se ka patur një ngarkesë të konsiderueshme pune edhe në lidhje me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet gjyqësore të huaja dhe konkretisht gjatë këtij viti i janë dërguar autoriteteve gjyqësore kompetente 32 kërkesa për ndihmë juridike në fushën penale, ndërkohë që janë dërguar prej autoritetet gjyqësore të huaja në drejtim të Prokurorisë Korçë 10 kërkesa për ndihmë juridike në fushën penale. Po kështu, rezulton se është bërë 6 njohje vendimi penal të huaj.

Konstatohet një korrektësi maksimale në raport me autoritetet gjyqësore të huaja në përmbushjen e detyrimeve ligjore, në një kohë kur pritet që edhe autoritet e huaja gjyqësore të na përgjigjen me të njëjtën shkallë korrektësie.

XV. Marrëdhëniet me institucionet e tjera.

Gjatë vitit 2015 është synuar rritja e bashkëpunimit sidomos me strukturat e policisë së shtetit, që përbën një element shumë të rëndësishëm të suksesit në punën e prokurorisë. Bashkëpunimi i mirë ka funksionuar si në nivel titullarësh por edhe në nivelin bazë dhe ka dhënë rezultatet e veta. Theksi është vënë në përmbushjen e detyrimeve të policisë gjyqësore, rritjen e nivelit profesional të tyre, eliminimin e zvaritjeve të pa justifikuara dhe ritjen e cilësisë së hetimit me qëllim për të qënë më të suksesshëm në parandalimin dhe goditjen, sidomos të veprave penale më të përhapura në këtë rreth.

Ka një përmirësim të bashkëpunimit me pushtetet vendore dhe institucionet e tjera lokale me synimin për të marrë prej tyre në kohë informacionin e nevojshëm në interes të hetimit. Edhe përsa i përket ekzekutimit të vendimeve penale, bashkëpunimi me IEVP dhe Shërbimin e Provës ka qënë mjaft i mirë.

Përsa i përket marrëdhënieve të punës me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, ato kanë qënë korrekte dhe të bazuara në ligj. Ka patur një përmirësim të ndjeshëm të raporteve me këtë gjykatë sidomos për zgjidhjen e problemeve të natyrës administrative.

Me Prokurorinë e Apelit Korçë vazhdojnë të ruhen marrëdhënie të mira shoqërore dhe institucionale. Kjo prokurori na ka mbështetur në të gjitha kërkesat tona të ligjshme dhe ka orientuar qëndrimin tonë për çështje konkrete.

PRIORITETET E PUNËS SË KËSAJ PROKURORIE GJATË VITIT 2016

Në përfundim pasi kemi analizuar, ballafaquar shifra dhe të dhënat që gjithësesi janë kokëforte të gjithë ne si përfaqësues të shtetit dhe prokurorisë shqipëtare duhet që këtë vitit të ri profesional të angazhohemi:

- Për më shumë profesionalizëm për fazën e hetimit paraprak dhe përfaqësimin dinjitoz të akuzës në gjykim. Nga rezultatet e këtyre fazave varen të gjithë treguesit e tjerë cilësorë të punës. Do punohet për te përfunduar brenda një kohe të arsyeshme çështjet penale të cilat janë mbartur në hetim apo në gjykim. Do synohet minimizimi i pushimit të çështjeve me të arrestuar.
- Do synojmë rritjen e numrit të gjykimeve të drejtpërdrejta, duke e ç'rrenjosur nga kujtesa e publikut idenë se **“Njëdrejtësi e vonuar është njëdrejtësi e mohuar”**. Duke qënë se njëpjesë e konsiderueshme e çështjeve të regjistruara janë për veprën penale të vjedhjes ku pjesa më e madhe e veprimeve janë kryer që në momentet e para, dërgimi i tyre për gjykim të drejtpërdrejtë do të ulte ndjeshëm ngarkesën e Prokurorëve dhe *impakti pozitiv në publik do ishte i ndjeshëm*.
- Do t'u kushtohet vëmendje e vecantë çështjeve të krimit ekonomik dhe korrupsionit, duke synuar rritjen e hetimeve proaktive në këtë fushë duke bashkëpunuar ngushtë me të gjitha agjencitë e zbatimit të ligjit. Do te synojme rritjen e numrit të hetimeve kryesisht.
- **Ideja se prokuroria është pedante dhe shumë pak diligjente në hetime duhet dhe do të jetë një pjesë e së kaluarës.**
- Do reflektohen në veprimtarinë e përditshme ndryshimet e reja të Kodit Penal duke iu kushtuar vëmendje e vecantë çështjeve të vjedhjes së pasurisë së shtetit si psh energjia elektrike, dhunës në familje, informalitetit ekonomik dhe ashpërsimit të dënimeve për vepra penale të përhapura, **në përputhje me politikën penale kombëtare**. Njëkohësisht një politikë më humane penale ndaj masave të dënimit për të miturit dhe të pandehurat femra.
- Gjithashtu do t'i kushtohet vëmendje e vecantë kërkesave për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”. **Prokuroria duhet të jetë më aktive në kërkimin e masave të sigurimit personale shtrënguese dhe ndalueseduke mos u kufizuar vetëm në veprimet me iniciativë të shërbimeve të policisë gjyqësore.**
- Angazhohemi për një bashkëpunim edhe më të frytshëm me policinë gjyqësore, duke qënë se roli i tyre në punën tonë të përditshme është i një rëndësie shumë të madhe. Do synohet rritja e kontrollit të prokurorit në hetimin e çështjeve duke deleguar për këtë qëllim detyra

sa më të qarta dhe duke kërkuar kryerjen e tyre në një afat sa më të arsyeshëm. *Gjithashtu do t'i kushtohet vëmendje e vecante veprimtarise se Komisionit Disiplinor.*

- Ndër objektivat dhe prioritetet që kërkohet të arrihen nga ana jonë kanë qenë dhe vazhdojnë të mbeten edhe marrëdhëniet me autoritetet e drejtësisë së shteteve të tjera (gjë që natyrisht kërkon një ndihmë nga hallka hierarkike më e lartë); me institucionet e ndryshme, permiresimi i vendimmarrjes dhe rritjes profesionale te metejshme te prokurorëve dhe policisë gjyqësore.
- Do t'i kushtohet vëmendje e vecantë rritjes së transparencës institucionale duke patur parasysh në cdo rast çështjen e karakterit sekret të hetimeve.
- Gjatë këtij viti pune, prokurorët dhe oficerët e policise gjyqësore janë angazhuar në trajnime, në kryerjen e hetimeve me ndershmëri dhe seriozitet, ngritjen e akuzave të drejta e të bazuara në prova e në ligj. Ata në çdo rast kanë treguar etikë të lartë morale dhe profesionale si dhe kryerjen e punës me përkushtim dhe ndërgjegje ku gjatëushtrimit të funksionit, janë mbajtur parasysh gjithmonëurdhërat e Prokurorisë së Përgjithshme.

Punë të mbarë për këtë vit të ri profesional!

Duke ju falënderuar për vëmëndjen!

DREJTUESI I PROKURORISË

Kolë HYSENAJ

Kompetenca Tokësore



Kompetenca Lëndore.

